ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Një ankesë kundër: Vendimi i datës 19.01.2023 i Qendrës Klinike Universitare të Kosovës – Departamenti i Prokurorimit.

Për Aktivitetin e Prokurimit Numër e-prokurorimi: **701-22-14388-2-2-1 dhe nr. të brendshëm 701-22-244-221.**

Sa i përket tenderit për **"RITENDER – Shërbimet e DDD për të gjitha hapësirat e brendshme dhe të jashtme të QKUK-së".**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit

DOCTOR EXTERMINATOR D.D.D. SH.P.K.

MEHMET AKIF ERSOY , Nr.17, TASLIXHE II
(Adresa)

Prishtinë — 10000
(Vendi) — *(Kodi Postal)*

+38344158638 — -
(Numri i telefonit)(Numri i faksit)

Dr.Lulzim Katanolli
(emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

drkatanolli@yahoo.com
(adresa elektronike)

27.01.2023
(data e parashtrimit të ankesës) — *(nënshkrimi dhe vula)*

DOCTOR EXTERMINATOR DDD SH.P.K. N.U.I. 811498957 Prishtinë

***Ankues mund të jetë pala e interesuar (operatori ekonomik apo grupi i operatorëve ekonomik pjesëmarrës në aktivitetin e prokurimit).*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(emri i avokatit)

_____

(adresa e plotë)

_____ _____

(numri i telefonit) *(numri i faksit)*

_____

(adresa elektronike)

_____ _____

(data e parashtrimit të ankesës) *(nënshkrimi dhe vula)*

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Një përshkrim i shkurtër lidhur me datën dhe emrin e gazetës (ve) ditore në të cilën (at) është publikuar " Njoftimi për Kontratë" si dhe "Njoftimi për dhënie të Kontratës", afati i fundit për dorëzimin e tenderit, data dhe ora e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

-Ky aktivitet i prokurimit ka të bëjë me tenderin "RITENDER – Shërbimet e DDD për të gjitha hapësirat e brendshme dhe të jashtme të QKUK-së" *me nr. prokurimi: 701-22-14388-2-2-1;*
- Me daten: 19.12.2022 autoriteti kontraktues ka publikuar dokumentin:B05 Njoftim per Kontrate
- Me daten: 30.12.2022, autoriteti kontraktues ka publikuar dokumentin:B54 Formular Standard për korigjimin e gabimeve në njoftimet e publikuara.
- Me daten: 06.01.2023, autoriteti kontraktues ka publikuar dokumentin: Informata shtese pyetje dhe pergjigje.
- Me daten: 09.01.2023, autoriteti kontraktues ka publikuar dokumentin: B54 Formular Standard për korrigjimin e gabimeve ne njoftimet e publikuara,
-Me datën 24.01.2023, autoriteti kontraktues ka publikuar dokumentin: B54 Formular Standard për korigjimin e gabimeve në njoftimet e publikuara.
Me datën 25.01.2023, autoriteti kontraktues ka publikuar dokumentin: B54 Formular Standard për korigjimin e gabimeve në njoftimet e publikuara.

4. Procesi i Hapjes së tenderëve

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐ **Jo** ☐

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ? A keni bërë ndonjë reagim me shkrim dhe/ose kërkuar sqarime shtesë nga AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj, si dhe a u është përgjigjur me shkrim AK në lidhje me këtë? Nëse po, ofroni shkurtimisht detaje mbi këtë fakt:

Po ☐ **Jo** ☐

6. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë e gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës:

Konsiderojmë se janë shkelur dispozitat ligjore si në vijim:

- *Neni 1 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurim Publik.*
- *Neni 5 pika 1.1 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurim Publik.*
- *Neni 7 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurim Publik.*
- *Neni 9 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurim Publik.*
- *Neni 13 par.4 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurim Publik.*
- *Neni 27 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurim Publik.*
- *Neni 28 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurim Publik.*
- *Neni 51 par.3 pika 3.6, të Ligjit Nr. 04/L-120 Për Mbrojtjen e Bimëve,*
- *Neni 3 par.1.4 dhe par.1.13 të Ligjit Nr.06/L-011, Për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik,*
- *Neni 5, të Ligjit Nr.06/L-011, Për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik,*
- *Neni 6 të Ligjit Nr.06/L-011, Për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik,*

  Neni 13 të Ligjit Nr.06/L-011, Për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik.

*** Sipas nenit 113 të LPP-së, OSHP-ja do të konfiskoj Sigurimin e Ankesës tuaj, nëse Paneli Shqyrtues konstaton se të gjitha apo cilado nga pretendimet e bëra në ankesë kanë qenë të rrejshme apo mashtruese.*

7. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Në pajtim me të gjitha dispozitat ligjore për konkurim në tender publik, kompania DOCTOR EXTERMINATOR D.D.D. SH.P.K., dëshiron të aplikoj në tenderin me titull: " RITENDER – Shërbimet e DDD për të gjitha hapësirat e brendshme dhe të jashtme të QKUK-së" *me nr. prokurimi: 701-22-14388-2-2-1 dhe nr. të brendshëm 701-22-244-221*". Afati i fundit për dorëzim të tenderëve është dt.06.02.2023 në ora 12:00, po ashtu afati i njëjti për hapjen e tenderëve dt.06.02.2023 në ora 12:00, afat ky i shtyer sipas njoftimit të dt.25.01.2023.

Autoriteti Kontraktues, duke vendosur në kërkesën për rishqyrtim të OE-ve, të njëjtat i refuzon si të pabazuara, dhe verteton vendimin e vet të AK, lidhur me dosjen e tenderit të publikuar me 16.12.2022 dhe sqarimeve të dhëna me 05.01.2022, kurse AK SHSKUK, të vazhdon me tutje aktivitetin e Prokurorimit "RITENDER – Shërbimet e DDD për të gjitha hapësirat e brendshme dhe të jashtme të QKUK-së" *me nr. prokurimi: 701-22-14388-2-2-1 dhe nr. të brendshëm 701-22-244-221.*

Vendimi i dt. 19.01.2023 nga AK SHSKUK – Departamenti i Prokurorimit i cili mbeshtet vazhdimin e procesit të prokurimit *me nr:prokurimi: 701-22-14388-2-2-1 dhe nr. të brendshëm 701-22-244-221*, sa i përket tenderit për " RITENDER – Shërbimet e DDD për të gjitha hapësirat e brendshme dhe të jashtme të QKUK-së", është proces jo i rregullt për shkak se është marr në shkelje të dispozitave ligjore si më poshtë:

- *Neni 1 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurim Publik.*
- *Neni 5 pika 1.1 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurim Publik.*
- *Neni 7 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurim Publik.*
- *Neni 9 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurim Publik.*
- *Neni 13 par.4 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurim Publik.*
- *Neni 27 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurim Publik.*
- *Neni 28 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurim Publik.*
- *Neni 51 par.3 pika 3.6, të Ligjit Nr. 04/L-120 Për Mbrojtjen e Bimëve,*
- *Neni 3 par.1.4 dhe par.1.13 të Ligjit Nr.06/L-011, Për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik,*
- *Neni 5, të Ligjit Nr.06/L-011, Për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik,*
- *Neni 6 të Ligjit Nr.06/L-011, Për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik,*
  Neni 13 të Ligjit Nr.06/L-011, Për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik.

Në vazhdim paraqiten pretendimet e përgjithshme të procesit të tendërimit që konsiderojmë se nuk janë respektuar nga AK, të cilat do ti listojmë si në vijim:

- Autoriteti kontraktues ka shkelur nenin 1 par. 1, 2 dhe 3 të ligjit për Prokurim Publik. Ashtu që neni 3 par.1 i Ligjit për Prokurorimin publik përcakton se "*Qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë duke përcaktuar kushtet dhe rregullat*

që do të zbatohen, procedurat që do të ndiqen, të drejtat që do të respektohen dhe detyrimet që do të përmbushen nga personat, operatorët ekonomik, ndërmarrjet, autoritetet kontraktuese, koncesionerët e punëve dhe organet publike që zhvillojnë, përfshihen, marrin pjesë ose interesohen, në aktivitetet e prokurimit ose që përfshihen ose kanë të bëjnë me fondet dhe/ose burimet e tilla", e që AK, në mënyrë direkte i shkelë të tre paragarafet e nenit 1 të LPP-së, me rastin e përgatitjes së specifikacioneve të tilla në dosjen e tenderit të cilat do të elaborohen radhazi në vijim.

- Fillimisht tek Kapacitet teknik dhe Profesional, përkatësisht KERKESA nr.7, Autoriteti Kontraktues cek se " Operatori ekonomik duhet te ofroj stafin e nevojshem qe do te angazhohet ne kete projekt: B) 2 INSPEKTOR SANITAR". Autoriteti Kontraktues në mënyrë direkte shkel nenin 2 të Ligjit për Për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik në të cilin përcaktohet se *"Dispozitat e këtij ligji përcaktojnë parimet, rregullat dhe procedurat lidhur me sjelljet e lejuara dhe të ndaluara të zyrtarëve gjatë kryerjes së detyrës publike si dhe masat e parapara për shkeljen e dispozitave të përcaktuara në këtë ligj. Ky ligj rregullon gjithashtu procedurat për detyrimet e raportimit, masat për parandalimin, identifikimin, menaxhimin dhe zgjidhjen e rasteve të konfliktit të interesit publik dhe private të zyrtarit gjatë dhe pas ushtrimit të detyrës publike si dhe detyrat e përgjegjësitë e autoriteteve përgjegjëse"*, lidhur me nenin *5*, po atë njëjtit ligj që ka të bëjë me **Parimet e veprimit dhe mosveprimit të zyrtarit,** po ashtu bazuar në nenin 6 të këtij ligji përcaktohet se "*Konflikti i interesit lind nga një rrethanë në të cilën zyrtari ka interes privat, që ndikon, mund të ndikojë ose duket se ndikon në kryerjen me paanshmëri dhe objektivitet të detyrës së tij zyrtare*", po ashtu edhe sipas nenit 13 par. 1 të Ligjit të lartë cekur përcakton se "*Zyrtari i lartë nuk mund të jetë menaxher, përfaqësues i autorizuar ose anëtar i ndonjë organi menaxhues apo mbikëqyrës i personave juridikë privatë, fitimprurës sipas ligjit përkatës për shoqëritë tregtare dhe organizatave joqeveritare, përjashtuar subjektet e përcaktuara në nenin 14 të këtij ligji, subjektet politike si dhe rastet kur një funksion i tillë i dedikohet me ligj për shkak të funksionit*", andaj bazuar në të lartë cekuar konstatohet në mënyrë të pakontestueshme se kushti për "2 Inspektor Sanitar" të vënë nga AK, është në kundështim të plotë me frymën e Ligjit *Nr.06/L-011, Për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik, po ashtu një kërkesë e tillë është në kundërshtim* me Inspektoratin Sanitar te Republikes se Kosoves i cili është një institucion i pavarur dhe ne si Operator Ekonomik nuk duhet të mirremi me punen që kryhet nga Inspektoret e Inspektoratit Sanitar të Kosovës, për shkak së një gjë e tillë është konflikt i hapur i interesit. Po ashtu është për tu çuditur fakti sepse AK, përmes njoftimit të dt.24.01.2023, i heqë dy inspektorët sanitar, kurse prapë me dt.25.01.2023, i kthen të njëjtit sikur kusht apo kriter në specifikacione.

- Po ashtu në lidhje për kërkesën Nr.7, Kapaciteti teknik dhe Profesional, Autoriteti Kontraktues thote se: "Duhet te angazhohet nje BIOLOG". Ne si OE kemi pyetur ne kerkesen per informacione shtese se: "*Pse eshte kerkuar nje biolog me certifikate laboratorike dhe çfare roli është i biologut dhe i certifikates laboratorike per sherbimet DDD ne QKUK*? Autoriteti Kontraktues përgjigjet se "Biologu njeh mikroorganizmat e deri te gjallesat me te medha, gjithashtu edhe botaniken dhe mund te vleresoj nderhyrjet ne procesin e DDD-se, duke tentuar te ruaj ne pergjithesi ne bashkepunim me Ekologun dhe Epidemiologun ekosistemin e pandemshem. Gjithashtu Biologu i laboratorit është ne gjendje ne rast kur shihet e arsyeshme nga OE per te marr mostra ku shihet e nevojshme dhe per te vendosur nese procesi i DDD-së, duhet te shtyhet tutje, aty ku shihet e nevojshme. Ekuivalent nje roli te tille jane te mirëseardhur.(Shih sqarimin ne informatat shtese).

- Sqarimet qe jepen nga Autoriteti Kontraktues ne lidhje me punen e BIOLOGUT jane te pakuptimta me lidhjet me sherbimete DDD-se, dhe roli kryesore eshte parandalimi i semundjeve infektive ku Epidemiologu e ka rolin kryesor si dhe perdorimim e preparateve adekuate per eliminimin dhe kontrollomin e infektimit me insekte, brejtës si dhe dezinfektimin e githa siperfaqeve duke perdorur preparate adekuate me efikasitet maksimal ne eliminimin e problemit të insekteve, brejtesve dhe mikroorganizmave te cilat jane bartes dhe shkaktar të semundjeve infektive. Perdorimi i preparateve duhet te bazohet ne fletet e te dhenave te sigurise mjekesore. Sa i perket biologut te laboratorit, nuk eshte kompetent te mirret me marrjen e mostrave pershkak se: Në Republiken e Kosoves ekziston Instituti Kombetar i Shendetit Publik i Kosoves (IKSHPK) i cili eshte Institucion i Autorizuar ti merr edhe perpunon mostrat e duhura sipas nevojes. Me kete rast, Autoriteti Kontraktues shkel nenin 7 par.2 të LPP-së, në të cilin përcaktohet se "Autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë te një ose më shume operatoreve ekonomik", e kjo për arsye se kërkesa për Biolog është në kundërshtim të hapur me të lartë cekurat si dhe tendencë për të favorizuar OE, të caktuara, e që në mënyrë automatike eleminon apo diskriminon OE, të tjera.

- Pretendimi i radhes sa i përketë Kapacitetit teknik dhe Profesional, po ashtu kërkesa nr.7, Autoriteti Kontraktues thote: Duhet te angazhohet nje EKOLOG. Ne si OE, kemi kerkuar sqarim se pse eshte kerkuar nje ekolog edhe çfare roli ka ne sherbimet e DDD-se, ne QKUK? Autoriteti Kontraktues thote: Ekologu vlereson EKOSISTEMIN dhe duhet te merr strategjine e nevojshme te shkaktoj sa me pak deme. Nje Shqetesim i tille eshte ngritur ne qarqet nderkombetare çka eshte pare e nevojshme qe ne ndermarrjet e DDD-se, sidomos ne kemi te bejme me intervenime jashte te kemi nje ekolog ambientalist". (Shih sqarimin ne infornmatat shtese).

- Ne si OE nuk mund të pajtohemi me sqarimet e dhëna nga Autoriteti Kontraktues ne lidhje me punen e EKOLOGUT për shkak se të njëjtat nuk janë sqarime të sakta dhe të mbeshtetura në fakte shkencore në lidhjet me sherbimete DDD-se, dhe roli kryesore eshte parandalimi i semundjeve infektive ku epidemiologu e ka rolin kryesor si dhe perdorimin e preparateve adekuate per eliminimin dhe kontrollimin e infektimit me insekte, brejtes si dhe dezinfektimin e gjitha siperfaqeve duke perdorur preparate adekuate me efikasitet maksimal në eliminimin e problemit te insekteve, brejtesve dhe mikroorganizmave te cilat jane bartes dhe shkaktar te semundjeve infektive. Perdorimi i preparateve te bazuar ne fletat e te dhenave te sigurise mjekesore eshte e mjaftueshume. Per sherbimet e deratizimit perdoren shtepizat me karrem i cili parandalon ndotjen e ambientit si dhe bazuar në fleten e te dhenave te sigurise mjekesore (MSDS) preparatet te cilat perdoren per dezinsektim jane preparate te cilat zberthehen nga vet natyra, duke ruajtur ekosistemin qe permendet si arsyetim jo adekuat dhe as se si i saktë nga Autoriteti Kontraktues, e që në mënyrë automatike në kundërshtim me nenin 9 par.1 të LPP-së, sepse AK është duke përpiluar një dosje tenderi favorizues dhe diskriminues.

- Lidhur me pretendimin e radhës tek Kapiciteti Teknik dhe Profesional, EVIDENCA nr.7, Autoriteti Kontraktues kërkon nje pasqyrë tabelare te personelit te angazhuar qe duhet te dorezohet ne origjinal dhe i nenshkruar dhe i vulosur nga ATK. Autoriteti kontraktues shkel ligjet e prokurorimit publik duke kerkuar nga nje OE te kete pozitat qe ka kerkuar ne kapacitet profesional si punetore permanent duke favorizuar dhe diskriminuar OE te tjera te cilat nuk i posedojne ato, e nga kjo shihet qartë se kemi të

bëjmë me një tender të parapërgatitur, po ashtu sa për rikujtim sepse edhe në procedura tjera të prokurorimit janë tentuar gjërat e njëjta me Lista paraprake nga ATK, por që OSHP, ka vendosur që një gjë e tillë është në kundërshtim me ligjin (shih: rastin PSH.nr.639/22 dhe rastin PSH.nr.283/22 të dt.03.10.2022, raste këto lehtë të qasshme nga OSHP, si organ kompetet që vetë i ka nxjerrë, dhe nuk mund të veprohet në kundërshtim me këto raste për shkak se cenohet parimi i sigurisë juridike). Po ashtu në lëminë juridike dhe në çdo punë kontraktuese ekzistojnë kontratat mbi vepër për të kontraktuar sipas nevojës profesionist nga lëmi të caktuar për kohë të caktuar dhe me detyra të caktuara sipas specifikimeve të ndonjë tenderi, dhe çdo kusht paraprak për të pasur një apo dy profesionist të çfarë do lëmie tregon qartë se kemi të bëjë me diskrimin dhe favorizim të ndonjë OE.

- Po ashtu sa i përketë pretendimit lidhur me Kapacitetin Teknik dhe Profesional. KERKESA 8, C), ku autoriteti kontraktues kerkon: 5 paisije per pastrimin e ajrit brenda objektit qe largon grimcat PM 2.5 dhe PM 10 si dhe largimin e viruseve. Ne Informatat shtese, ne si OE kemi kërkuar sqarim "Se pse duhet 5 pajisje për pastrimin e ajrit brenda objektit që largon pm 2.5 dhe pm 10 si dhe largimin e viruseve. Autoriteti kontraktues thote: Serish vijme tek pika e njejte, vlerësojmë se është e nevojshme kaq numri shkaku i siperfaqes si QKUK dhe moslerjes e rastesise se ndodhjes se gabimeve por te mbulohet çdo m3 ne QKUK. Autoritet Kontraktues shkel nenin 7 të LPP-së, duke krijuar nje dosje me kapacitet teknik dhe profesional favorizues e diskriminuese. Operatoret ekonomik në lemin e DDD-se kryejne sherbimin e dezinfektimit qe ka veprim residual rreth 21 dite. Sipas kerkeses se AK-se, kerkohet qe te ketë 2 here dezinfektime gjate vitit por njëkohesisht kerkon 5 paisije per "pastrima dhe virusve qe nuk ka kurrëfarë kuptimi logjik dhe bije ndesh me sherbimin e dezinfektimit. Po ashtu këto 5 paisje e pastrojnë ajrin në një sipërfaqe prej 50 deri 100 m^2, kurse sipërfaqja e tërësishme e brendshme e QKUK-së, është 128,705 m^2, andaj po të pjesëtohet kjo sipëfaqe me 5 (paisje), na jep se një paisje e tillë duhet të pastroj 25,741 m^2, kurse kapaciteti i tyre për pastrim të ajrit është 50 deri 100 m^2, pra me një logjikë të thjesht dhe kalkulim të thjeshtë konstatohet se favorizohet OE, që posedon këto paisje por që gjithsesi nuk mund të mbulohet sipërfaqja e brendshme e QKUK, andaj edhe ky kriter i caktuar nga Autoriteti Kontraktues ka shkelur edhe nenin 9 par.1 të LPP-së, përcaktohet se "*Para se të fillohet me ushtrimin e çfarëdo aktiviteti të prokurimit, ZKA i autoritetit kontraktues duhet të sigurojë që të bëhet një vlerësim formal i nevojave dhe që rezultatet e këtij vlerësimi të regjistrohen formalisht me shkrim dhe të ruhen në dokumentacionin e autoritetit kontraktues. Me këtë vlerësim përcaktohen (i) lloji dhe përmasat e sakta të nevojave të veçanta të autoritetit kontraktues që prokurimi i propozuar parasheh t'i plotësojë; (ii) vlera e parashikuar, lloji i propozuar dhe kushtet përmbajtjesore të kontratës publike që do të jenë lëndë e prokurimit të planifikuar; (iii) specifikimet e propozuara funksionale të secilit objekt që do të përfshihet nga një kontratë e tillë; (iv) përfitimet e pritura nga secili objekt i tillë; (v) në rastin e pajisjeve, mallrave të qëndrueshme dhe punëve, përllogaritja e shpenzimeve të disponimit gjatë tërë afatit të përdorimit të objektit, duke përfshirë shpenzimet e blerjes, operative, mirëmbajtjes si dhe vlerës së mbetur; (vi) një njoftim, mbi atë se nëse aktiviteti i tillë i prokurimit ishte përfshirë në planifikimin e prokurimit, në përputhje me nenin 8 të këtij ligji dhe nëse nuk ishte përfshirë, atëherë një deklaratë mbi arsyet e mos-përfshirjes së tillë; dhe (vii) konstatimin e saktë mbi atë se në çfarë mënyre do të avancojë prokurimi përkatës synimet institucionale të autoritetit kontraktues*" andaj vlersojmë se AK ka bere shkelje të këtij nenit me rastin e mos-harmonizimit të kërkesave në terren dhe vlerës apo kapacitetit të parashikuar, po ashtu shkelja e radhes nga Autoriteti Kontraktues ka dështuar të veprojë sipas nenit 7 par.1 të LPP-së, në të cilin përcaktohet se "*Autoriteti kontraktues do ti trajtoj*

operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparent" lidhur me par. 2 të njëjtit nen dhe ligj ceket se "*Autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë te një ose më shume operatoreve ekonomik*", andaj me rastin e mos ofrimit të informatave shtesë, për shpejtimi të procedurave pabazë ligjore, ne si OE Ankues konsiderojmë se edhe këta dy paragraf të këtij neni dhe ligji janë shkelur nga Autoriteti Kontraktues me rastin e pergatitjes se një specifikacioni diskriminues.

- Lidhur me pretendimin sa i përketë Specfikimit teknik dhe profesional, Autoriteti kontraktues kerkon: liste te mjeteve dhe paisjeve teknike qe janë ne dispozicionin tuaj per te ekzekutuar kontraten ne fjale. Pajisjet dhe makineria, ne dispozicion, duhet te kene certifikime ISO per cilesi dhe te deshmohen me kopje te librezave mbi pronesine e tyre ose DUD doganor dhe fatura e blerjes ose kontrata mbi qiramarjen te noterizuar. Autoriteti Kontraktues shkel ligjet e prokurimit publik duke e publikuar nje specifikim teknik te mos harmonizuar dhe konfuz duke e dite se jo te gjitha makinerite kane ISO standarde te cilesisë si dhe duke kerkuar "librezat mbi pronesine e tyre qe eshte një absurditet. Pajisjet e kerkuara me ISO standarde per cilesi kane tendence favorizuese dhe diskriminuese, po ashtu edhe arszetimi në vendim i AK, se kërkohen edhe sistemi i çertifikimit ISO OHSMS 45001-2018, konsiderojmë se një sistem i tillë nuk ekziston në Kosovë dhe nuk mjafton vetëm të citohet termi "Occupational Health and Safety Managmet System", për shkak se nuk dihet ky sistem a është i aplikuar apo implementuar në Kosovë.

- Dhe në fund Autoriteti Kontraktues shkel ligjet e prokurimit publik duke e larguar sulfurin si repelent me pretendimin se transporti i sulfurit nuk lejohet per shkak te demit me te madh qe shkakton dhe lejohet cinnamon oil dhe produket equivalente (shih te informatat shtese ku parastrohet pyetja rreth heqjes se sulfurit nga OE "MONUNI") duke prentenduar se nuk është substance biocide dhe institucioni relevant per leshimin e importit te sulfurit nuk e konsideron si produket biocid dhe nuk leshon leje per nje preparat të tillë. (Shih te bashkangjitur dokumentin per leje te importit te sulfurit, në faqen 8 të Kërkesës për Rishqyrtim. Materia aktive sulfur është e lejuar të përdoret si repelent në Republiken e Kosovës në bazë të ligjit: 2009/70 Reg.(EU)No.5402 011 si substance biocide).

Nga shqyrtimi i kësaj ankese, provat e bashkëngjitura, dispozitat e shkelura ligjore, kërkesat e dosjes së tenderit konstatohet në mënyrë të pakontestueshme se OE Ankues ka të drejtë lidhur me pretendimet e ngritura, që të gjitha këto pretendime në një analizë të mirëfillt të provave dhe bazës ligjore dëshmojnë shkeljet e bëra nga AK dhe domosdoshmerinë e anulimit të vendimit të AK.

8. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës:

- Mosdhënia e kësaj kontrate kompanisë tonë rrezikon të n'a shkaktoj dëme materiale për vlerën e fitimit të munguar. Njëkohësisht do të bëjë dëmtimin e reputacionit tonë si njëra ndër kompanitë më të njohura për lemin e Dezinfektimit, Deratizimit dhe Dezinsektimit.

9. Propozim

Ofroni, nëse është e mundur propozimin tuaj për hapat e mëtutjeshëm në lidhje me këtë aktivitet të prokurimi:

Që Organin Shqyrtues të Prokurorimit, me seli në Prishtinë, ta APROVOJ ankesën si të BAZUAR, Vendimin e dt. 19.01.2023 të AK SHSKUK – Departamenti i Prokurorimit që të njëjtin ta PRISHË dhe çështja të kthehet në rivendosje në organin e shkallës së parë.

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Regjistroni secilën dëshmi të cilën do t'ibashkëngjitni ankesës tuaj. Në mënyrë që ankesa juaj të merret në shqyrtim, duhet të ketë të bashkangjitur patjetër ***Publikimin e Njoftimit për Dhënie të Kontratës*** *me të cilën do të dëshmohet data si dhe emri i gazetës në të cilën është publikuar ky njoftim apo njoftimin e kandidatëve dhe tenderuesve të eliminuar, procesverbalin e hapjes publike të tenderëve, si dhe të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë mekëtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*

1. Njoftimi për kontrat B05, i dt.19.12.2022 2. Formulari B54 standard per korrigjimin e gabimeve ne njoftimet e publikuara 30.12.2022, 3. Autoriteti kontraktues ka publikuar dokumentin: Informata shtese pyetje dhe pergjigje i dt. 06.01.2023, 4. Formulari B54 standard per korrigjimin e gabimeve ne njoftimet e publikuara 09.01.2023, 5. Formulari B54 standard per korrigjimin e gabimeve ne njoftimet e publikuara 19.01.2023, 6. Formulari B54 standard per korrigjimin e gabimeve ne njoftimet e publikua25.01.2023, 7. Kërkesë për rishqyrtim e datës 13.01.2023, 8. Vendim i AK SHSKUK, i dt.19.01.2023.

*** Sipas nenit 106.2 të LPP-së, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës në fjalë, do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe më pas një kopje të protokolluar nga OSHP-ja do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*